

## **PROCEDURA DHE RREGULLAT PER RREGJISTRIMIN E STUDENTEVE NE SEZONIN E DIPLOMIMIT PRILL 2020-2021**

Sezoni DIPLOMIMIT Prill 2020-2021 per programet "Bachelor", "Programe 2-vjecare Profesionale", "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave" te percaktuara sipas cdo fakulteti, do te kryhet ne periudhen 21/04/2021 deri 22/04/2021. Per programet "BACHELOR" dhe "Programe 2-vjecare Profesionale" data e diplomimit do te jete 21/04/2021. Kurse per programet Master (MP dhe MSC) data e provimit te diplomimit do jete 22/04/2021.

- Per sezonin e diplomimit rregjistrimi i studenteve do te kryhet online nga vete studentet nga data 18/04/2021 deri 20/04/2021 per studentet e programeve:
  - "Bachelor",
  - "Programe 2-vjecare Profesionale"
- dhe nga dt 19/04/2021 deri 21/04/2021 per studentet e programeve:
  - "Master Profesional"
  - "Master i Shkencave"
- Pas kesaj date asnje student nuk mund te kryeje veprime per rregjistrime ne provimet e ketij sezoni.
- Procedura dhe menyra e rregjistrimit do te afishohen ne monitoret e cdo fakulteti dhe ne websitin e universitetit ne linkun: “ **Udhëzime për organizimin e sezonit të provimeve** ”.
- Ne provimet e sezonit te diplomes nuk do te lejohen studentet qe nuk kane shlyer detyrimin e pageses se tarifes se shkollimit.
- Kujtojme se per tu rregjistruar ne sezonin e diplomimit, te gjithë studentet duhet te jene te pasjitur me te dhenat personale qe ata kane vendosur gjate procedures se rregjistrimit te tyre prane fakultetit ku ata studiojne. N.q.s studentet hasin veshtiresi me keto te dhena atehere duhet te komunikojne me sekretarite e departamenteve te fakultetit perkates per tu njohur me to.
- Pedagoget dhe sekretarite mesimore duhet te kene ngarkuar ne sistem te gjitha procesverbalet e provimeve qe u perkasin ketyre programeve deri me daten 18/04/2021.
- Studenti ne librezen e tij duhet te kete te gjitha lendet te vleresuara me note kaluese (me perjashtim te provimit te temes se diplomes).

### **Cilet studente kane te drejte te rregjistrohen ne sezonin e diplomes?**

1. Studenti duhet te jete DIPLOMANT – pra kontrollohet qe kursi i studentit te jete i barabarte me vitin e fundit te kohezgjatjes se programit. Mesazhi qe i shfaqet studentit eshte “Ju nuk jeni ne kursin e fundit. Ky sezon i dedikohet vetëm studentëve që janë për t’u diplomuar”

Per shkak te kushteve te vendosura nga sistemi lidhur me kete sezon, ata qe nuk plotesojne kriteret nuk do te mund te prenotohen dot. Per kete arsye studenti duhet te verifikoje ne fillim nese ka lende te pafrekuentuara, apo qe nuk i ka kaluese, para se te rregjistrohet ne sezonin e diplomimit.